REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 301
Datë/Datum. 29.09.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 29.09.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1543, të datës 01.09.2026, të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 61, paragrafi 61.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 2, paragrafi 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), Qarkoren Buxhetore 2027/2, me Nr. 987-2/2026, të datës 14.08.2026 të Ministrisë së Financave, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2028-2029

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027, në shumë të përgjithshme prej: 29,389,877.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike si vijon:

1.1 Për paga dhe shtesa për 1234 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 11,504,375.00€;
1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,500,000.00€;
1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 550,000.00€;
1.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 2,422,198.00€ dhe
1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 11,413,304.00€.

2. Vlerësimet e hershme të cekura me kufijtë për buxhetin e planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2028 është në shumë të përgjithshme prej: 30,933,678.00€ dhe për vitin fiskal 2029 është në shumë të përgjithshme prej: 32,985,875.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, mbështetur në tabelat buxhetore për Buxhetin e vitit 2027 për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve, të planifikuara dhe të përshkruara në paragrafin një dhe dy të këtij vendimi dhe zbatimi i tij, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së BF, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS OPŠTINA KOSOVO POLJE
KUVENDI FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fax/Br.str. 302
Data/Datum 01 10 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 29.09.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të 'Kërkesës për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026', në lidhje me rishqyrtimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, të Ministrisë së Financave, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 20/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M
Për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026 për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, për aprovimin e Propozimit Nr. 1544, të datës 02.09.2026, për ridestinimin e mjeteve financiare në shumë prej: 450,000.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i Projekteve' dhe bartjen e tyre për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, për realizimin e projektit kapital për 'Asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' me infrastrukturë përcjellëse në gjatësi prej 1300 metra' - në kodin e projektit Nr. 20945', sipas shkresës Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026 të Ministrisë së Financave.

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së BF, Drejtorisë së INFRAST dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 309
Data/Datum 01 10 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 30.09.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 295, të datës 25.09.2026, të paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin Nr. 05/L-007, nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 10/L-001, (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2026), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M
Për aprovimin e Propozimit Nr. 295, të datës 25.09.2026 për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 295, të datës 25.09.2026, për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, nën - programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi funksional 0112, kategoria ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të komunës, impianti i ujërave të zeza dhe projektet nga donatorët dhe Ministritë e linjës', përqindja e transferit 24.90%, të cilat transferohen për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, nën – programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, kodi funksional 0451, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi e projektit Nr. 20945, për realizimin e projektit kapital për 'Asfaltimin e rrugëve në Lismir: Tahir Mehaj dhe Ejup Gashi'.

2. Mjetet financiare të transferuara / rialokuara në programet buxhetore dhe kodet e projekteve përkatëse, do të shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital të evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi, me Nr. 20945.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Drejtorisë së Infrastrukturës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.lag/Br.sh. 304
Data/Datum 02.10.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 297, të datës 25.09.2026, të paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 14, paragrafi 1, nenin 15, paragrafi 11, të Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 10/L-001, (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2026), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M
Për aprovimin e Propozimit Nr. 297, të datës 25.09.2026 për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 297, të datës 25.09.2026, për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 162,777.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Infrastrukturës, nën - programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, kodi funksional 0451, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi e projektit Nr. 20975, 'Asfaltimi i rrugës Prekadini te Parku Rekreativ te Pishat në fshatin Sllatinë e Vogël', me përqindje prej 6.57% - transferohen për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, nën - programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, kodi funksional 0451, në kategorinë ekonomike Mallëra dhe Shërbime Nr. 13, burimi i financimit Nr. 10.
2. Mjetet financiare të transferuara / rialokuara në programin buxhetore nga kodi përkatës, do të shfrytëzohen për plotësimin e nevojave për mallëra e shërbime në nën - programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, për shumën e evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Drejtorisë së Infrastrukturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRATIVU
Nr.faq/Br.sv. 305
Datë/Datum 02.10.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 296, të datës 25.09.2026, të paraqitur nga Drejtoria e Arsimit për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin Nr. 05/L-007, nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 10/L-001, (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2026), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M
Për aprovimin e Propozimit Nr. 296, të datës 25.09.2026 për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 296, të datës 25.09.2026, për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 256,000.00€, me përqindje 15%, nga nën-programet buxhetore si vijon:

1.1 Nën-programi Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët, me Nr. 93030, kodi funksional 0912, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi i projektit Nr. 20867, 'Renovimi i Objekteve Shkollore' - për shkollat: Bajram Curri, Mihal Grameno, Mihal Grameno Aneksi 2, Daut Bogujevci, Vëllezërit Frashëri, Zejnel Salihu dhe Hivzi Sulejmani, në shumën e mjeteve financiare prej: 200,000.00€;

1.2 Nën-programi Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët, me Nr. 93030, kodi funksional 0912, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 21, kodi i projektit Nr. 20867, 'Renovimi i Objekteve Shkollore' - për shkollat: Bajram Curri, Mihal Grameno, Mihal Grameno Aneksi 2, Daut Bogujevci, Vëllezërit Frashëri, Zejnel Salihu dhe Hivzi Sulejmani, në shumën e mjeteve financiare prej: 56,000.00€ dhe

1.3 Mjetet financiare në shumën prej: 200,000.00€ nga burimi i financimit 10 dhe mjetet financiare në shumën prej: 56,000.00€ nga burimi i financimit 21 - transferohen për shpenzim në nën - programin Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët, me Nr. 93030, kodi funksional

0912, në kategorinë ekonomike Mallëra dhe Shërbime Nr. 13, nga burimet e financimit Nr. 10 dhe Nr. 21, të cekura në paragrafin një, nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2, të këtij vendimi.

2. Mjetet financiare të transferuara / rialokuara në programet buxhetore dhe kodet përkatëse, do të shfrytëzohen për plotësimin e nevojave për mallëra e shërbime të planifikuar në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në nën - programet e evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi për shumë e cekur në vendim.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Drejtorisë së Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 307
Datë/Datum 05.10.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për ndryshim-plotësimin Vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, për mbështetjen financiare mujore për fëmijët dhe të rriturit me Autizëm dhe Sindromën Dawn, me Nr. 1922, të datës 18.09.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (k, m, s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (gj, i, n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026 për lejimin e mjeteve financiare për mbështetjen e fëmijëve dhe të rriturve më Autizëm dhe Sindromën Dawn në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1922, të datës 18.09.2026, të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me ndryshim-plotësimin e paragrafit një (1), të vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, për lejimin e mjeteve financiare prej: 100.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. (200), programi Administrata e Shëndetësisë Nr. 73011, me plotësimin edhe 'Për personat e rritur me Autizëm dhe Sindromën Dawn', banorë të Komunës së Fushë-Kosovës.

2. Shpenzimi i mjeteve financiare nga paragrafi një (1) i këtij vendimi, do të realizohet sipas planit dinamik të shpenzimeve mujore / tremujore dhe vjetore të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nga një qind euro për secilin muaj dhe shpërndarjen e tyre tek fëmijët dhe të rriturit me Autizëm dhe Sindromën Dawn.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera administrative për zbatimin e këtij vendimi të Kuvendit të Komunës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit e Financave dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së BF, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fax/Br.str. 308
Data/Datum 05. 10. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të Rekomandimit me Nr. 300, të datës 29.09.2026, të paraqitur nga Komiteti për Komunitete i Komunës së Fushë-Kosovës, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f, n, s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 10/L-001, (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2026), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh, j, n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Rekomandimit Nr. 300, të datës 29.09.2026 të Komitetit për Komunitete për lejimin e mjeteve financiare për ndërtimin e objektit me karakterë shoqërorë në lagjen 029 në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Rekomandimit Nr. 300, të datës 29.09.2026, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 75,000.00€, nga buxheti i komunës për realizimin e projektit dy vjeçarë për ndërtimin e objektit me karakterë shoqërorë - 'Shtëpisë për kryerjen e të Pameve, me objekte përcjellëse tjera në lagjen 029 në Fushë-Kosovë', prej nën - programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi funksional 0112, kategoria ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të komunës, impianti i ujërave të zeza dhe projektet nga donatorët dhe Ministritë e linjës', me participimin edhe të qytetarëve të lagjeve 028 dhe 029 të Fushë-Kosovës.

2. Mjetet financiare të lejuara për ndërtimin e objektit të evidentuar në paragrafin një (1), të këtij vendimi, shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital në interes të përgjitshëm të komuniteteve jo shumicë - komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptian në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Drejtorisë së Gjeodezisë e Kadastrit dhe Drejtorisë së Integrimeve Evropiane.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë së Gjeodezisë e Kadastrit, Drejtorisë së Integrimeve Evropiane dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

Nr.fax/Br.tel. 309
Data/Datum 05.10.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 286, të datës 18.09.2026, në lidhje me caktimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', paraqitur nga Kryesuesi i Kuveendit të Komunës për ndryshim-plotësimin e paragrafit 3 të vendimit 15, të datës 28.01.2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, (Gazeta Zyrtare Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e Vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026 për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi' nga Komuna e Fushë-Kosovës

1. Me këtë ndryshim - plotësim të paragrafit tre (3) të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026 bëhet pezullimi konform emailit të datës 24.04.2026 - nuk parashihet kompenzimi i përfaqësuesve të aksionarit dhe bëhet largimi i përshkrimit nga vendimi i këtij paragrafi, pjesa tjetër e vendimit, mbetet e njëjta konform vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë Nr. 228, të datës 13.02.2026.
2. Emërimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', në përbërje e cekur në vendimin Nr. 15, të datës 28.01.2026 dhe përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës së këtij Komisioni, mbeten të plotëfuqishme dhe të zbatueshme konform vendimit të muajit janar 2026.
3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', zgjatë dhe është i ndërlidhur me mandatin zgjedhor të Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, KRM Pastrimi, Drejtorisë së SHPM, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
POLITIKA E ADMINISTRATIVËS - POLITIKA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 310
Datë/Datum 05.10.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026 dhe vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 586, të datës 31.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 2, paragrafi 1, paragrafi 3, nenin 8, nenin 13, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e 'Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

2. Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të taksave komunale vjetore për subjektet afariste, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e komunës.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, me ndryshim-plotësimet e saj.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera administrative për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe vlen së zbatuari nga data 01.01.2027 dhe shfuqizon Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63, të datës 16.03.2013.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
KUVENDI I KOMUNËS - OPŠTINA OPŠTINA
FUSHË-KOSOVË
KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.Log/Br.sl. 311
Data/Datum 05. 10. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.10.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit të paraqitur nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, lidhur me 'Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (s), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Planit të Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029

1. Për aprovimin e Planit të Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

2. Plani i Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029', e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për avansimin e të drejtave të komuniteteve për periudhën tre vjeçare në territorin e komunës.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani